MARTIN IVANAJ

LIGJET ZAKONORE NË FISET E SHQIPËRISË SË VERIUT (TRIESHI, HOTI DHE GRUDA)



MAL BERISHA

"VËSHTRIM DASHAMIRËS MBI DISERTACIONIN SHKENCOR TË MARTIN IVANAJT MBI TË DREJTËN ZAKONORE SHQIPTARE NË TREVAT E VERIUT"



MARTIN IVANAJ

LIGJET ZAKONORE NË FISET E SHQIPËRISË SË VERIUT (TRIESHI, HOTI DHE GRUDA)

Hyrje:

Këto ditë kam marrë një dhuratë jashtëzakonisht të çmuar nga znj. Drita Ivanaj, Themeluese dhe Presidente e Fondacionit *Martin & Mirash Ivanaj*.
Kjo dhuratë është një libër me vlera të rralla.


Teza e Diplomës së Dr. Martin Ivanaj

UNIVERSITETI MBRETËROR I ROMËS

KANUNI I LEKËS

(Codex Alexandri)

LIGJET ZAKONORE NË FISET E SHQIPËRISË SË VERIUT (TRIESHI, HOTI DHE GRUDA)

Për Amb. Mal Berisha
Përzemërsisht
Drita Ivanaj
21/12/2021

ROMË - Vjeshtë 1921

MALUKA

Ai titullohet:

"KANUNI I LEKËS"
(*CODES ALEXANDRI*)
LIGJET ZAKONORE NË FISET E SHQIPËRISË SË VERIUT (TRIESHI, HOTI DHE GRUDA)

Në të vërtetë, ky libër paraqet Tezën e Diplomës së Dr. Martin Ivanajt, e mbrojtur në Universitetin Mbretëror të Romës – sot i njohur si Universiteti *La Sapienza*.

Historia e jetës së atdhedashësve shqiptarë njeh pak shembuj me kontribute aq të larta sa ato të dy vëllezërve nga Veriu i Shqipërisë – Martin dhe Mirash Ivanaj. Pasardhësja e tyre, znj. Drita Ivanaj, është e bija e Martinit dhe Presidente e "Fondacionit Martin dhe Mirash Ivanaj".

Sa më shumë t'i njohësh ata, aq më shumë i do. Sa më shumë i do ata, aq më shumë të dhimbsen. Dhe sa më shumë të dhimbsen ata, aq më shumë të dhemb atdheu ynë. Atdheu ynë, që për dekada të tëra jo vetëm që nuk ua ka njohur vlerat, por i ka mohuar, dënuar dhe harruar.

Këtë ndjenjë e kam përjetuar kur, disa kohë më parë, shkrova dhe botova artikullin:

“FONDACIONI MARTIN & MIRASH IVANAJ – NJË XHEVAHIR KULTURE DHE DIJEJE NË ZEMËR TË TIRANËS.”

Sa më shumë i kthehem kujtimit të jetës dhe veprës së tyre, aq më shumë mësoj prej tyre. Madje ndjej gjithnjë e më qartë se sa e rëndësishme është që sa më shumë shqiptarë të njohin historinë e tyre dhe t’i marrin për model, aq më shumë djem e vajza shqiptare atdhedashës do të kemi.

DHURATA E ÇMUAR E DRITA IVANAJT.

Në 100-vjetorin e botimit të tezës së doktoraturës së babait të saj (1921–2021), Drita Ivanaj e botoi atë në tre gjuhë: fillimisht në gjuhën shqipe, më pas në gjuhën angleze dhe në fund në gjuhën italiane – gjuhën në të cilën teza ishte shkruar dhe mbrojtur në vjeshtën e vitit 1921.

PAK NGA BIOGRAFIA E MARTIN IVANAJT:

I lindur në Podgoricë, në një familje patriote nga zona e Trieshit, ai ndoqi shkollën e lartë në Pozharevc, si dhe kurse filozofie në Universitetin e Beogradit. Pas vdekjes së prindërve, ai shkoi për studime në Romë dhe, në vitin 1921, mbrojti doktoraturën në Jurisprudencë në Universitetin "La Sapienza".

Ai nuk pranoi ofertat që iu bënë në Romë për punë dhe një jetë të rehatshme, por u kthye në atdhe, ku shërbeu si

gjyqtar në Korçë dhe në Shkodër. Si i vetmi gjyqtar i kohës së vet me përvojë perëndimore, ai arriti të bëhej anëtar i Gjykatës së Lartë në Tiranë, anëtar i Këshillit të Lartë të Shtetit dhe Kryetar i Gjykatës së Lartë gjatë viteve 1932–1938. Ai la pas një trashëgimi të paçmuar në fushën e drejtësisë, jo vetëm në praktikë, por edhe përmes artikujve që shpjegojnë dhe pasurojnë kodet civile dhe penale të vendit tonë të asaj kohe.

Ai vdiq në moshën 52-vjeçare, në azil në Stamboll, duke lënë pas bashkëshorten e tij, profesoreshën Giuseppina Pogliotti–Ivanaj, dhe vajzën e tyre të vogël, Dritën.

Në hyrjen e këtij libri, Drita Ivanaj ka përshkruar një biografi të shkurtër të familjes së gjyshit të saj Dodës, të babait Martinit dhe të xhaxhait, Mirash Ivanaj – ky i fundit, ish-Ministri më i suksesshëm i Arsimit në historinë e Shtetit Shqiptar.

Kalvari i familjes Ivanaj, për shkak të persekutimit komunist, është i njohur. Mirash Ivanaj, i cili ishte kthyer në atdhe pas një periudhe mërgimi, u rikthye në vitin 1945 me kërkesë të Gjergj Kokoshit dhe u takua me Enver Hoxhën. Ky i fundit i premtoi se do ta kishte nën kujdes për veprën e tij të vyer në dobi të arsimit kombëtar shqiptar. Por ky takim rezultoi fatal për të. Në fund të bisedës, diktatori nuk harroi t'i kujtonte se "ishte vetë ai, Mirashi, që, kur kishte qenë Ministër i Arsimit, ia kishte ndërprerë bursën Enver Hoxhës." Mirash

Ivanajt i kujtohej mirë ky vagabond që nuk ndiqte studimet në Montpellier, dhe me sinqeritetin e një malësori të padjallëzuar iu përgjigj:

> "*Në kjoftë se nuk i ke dhanë provimet sipas rregullave të shtetit, mirë ta paskam ba!"*

Kjo i kushtoi jetën Mirash Ivanajt, pasi Enver Hoxha e burgosi menjëherë, duke bërë që ai të mos dilte më kurrë i gjallë nga burgu.

Në fakt, është një mrekulli që teza origjinale e doktoraturës së Martin Ivanajt u shpëtua, falë kujdesit të jashtëzakonshëm të bashkëshortes së tij, Giuseppina, si dhe përkujdesjes absolute të vetë universitetit, i cili kishte ruajtur kopjen e tretë të disertacionit në arkivën e tij.

Drita Ivanaj e ka ruajtur me fanatizëm këtë dokument të rrallë, me vlerë të jashtëzakonshme për të drejtën zakonore shqiptare.

Fatkeqësisht, pas ardhjes në pushtet të komunistëve, dorëshkrimet e tjera me shumë vlerë të tij u morën dhe u hodhën si sende pa rëndësi. Drita Ivanaj thekson se në këtë botim ka shumëçka për të mësuar rreth të drejtave të njeriut, të drejtës së pronës, familjes, nderit, dhe më tej.

Në këtë kanun mund të gjendet një vizion i qartë mbi ligjet e lashta shqiptare, të cilat, në kohën e Martin Ivanajt, ishin ende

të panjohura për botën perëndimore, ose ishin paraqitur në mënyrë të shtrembëruar nga studiues të huaj jo dashamirës ndaj shqiptarëve. Ai vendosi t'i bënte ato ligje të njohura, ligje që deri atëherë ishin transmetuar gojarisht nga një brez te tjetri. Sjellja e tyre në gjuhën shqipe, në një botim jubilar shekullor, përbën një pasuri të madhe të traditës sonë për juristët shqiptarë, të cilët do të dinë ta lidhin të drejtën zakonore të Veriut të Shqipërisë me kodet moderne të një drejtësie bashkëkohore.

Në hyrje të tezës së tij "Kanuni i Lekë Dukagjinit", autori Martin Ivanaj thekson se ky nuk ishte një ligj i shkruar. Për të ekzistojnë përmbledhje të ndryshme, ndër të cilat më e përhapura është ajo e botuar në "Hylli i Dritës" nga një frat katolik, në vitin 1914. Ky Kanun mund të përmbajë shembuj dhe nene të përgjithshme, por kjo nuk do të thotë se ato zbatohen njësoj në çdo krahinë të Veriut. Sipas Martin Ivanajt, ai botim i Kanunit të Lekës ka ngjashmëri me ***"Ligjet e Dymbëdhjetë Tabelave***", të cilat përbëjnë një grup rregullash të hartuara në vitet 451–450 para Krishtit, në Romën e Lashtë. Ky grup ligjesh përmban rregulla të së drejtës personale dhe publike.

Martin Ivanaj ka studiuar autorët e huaj më të njohur, ndaj të cilëve ka mbajtur qëndrime kritike, pro dhe kundër, si: Johann Georg von Hahn, Codexin e Stefan Dushanit, Galanti

(zakone dhe ligje zakonore), Baldacci (Revista Geografica Italiana), Barbarich, St. Novakovich, V. L. Montegazza, Gopçeviç, V. Vanutelli, Besker, H. Hecquart, A. Degrand, Giordana, Gaetano P. Sebert, etj.

Nderimit që Drita Ivanaj i ka bërë babait të saj në këtë vepër të rrallë, e cila i shërben njohjes së traditës sonë kombëtare, i bashkohem me gjithë zemër dhe me ndjenjë të thellë mirënjohjeje.

Faleminderit Ju, familja Ivanaj, për shërbimin që i keni bërë dhe vazhdoni t'i bëni kombit tonë! Krenar që jam shqiptar!

THE IVANAJ FOUNDATIONS
OF NEW YORK & TIRANA

Dr. MARTIN IVANAJ

First Century Commemoration

Përkujtimi i 100-vjetorit

1921 – 2021

R. UNIVERSITA' di ROMA

Tesi di Laurea

K A N U N I I L E K Ë S

(Codex Alexandri)

LEGGI CONSUETUDINARIE NELLE TRIBU' DELL'ALBANIA SETTENTRIONALE (TRIESHI, HOTI e GRUDA)

Martin IVANAJ

R O M A - Autunno 1921

Teza e Diplomës së Dr. Martin Ivanaj

UNIVERSITETI MBRETËROR I ROMËS

KANUNI I LEKËS

(Codex Alexandri)

LIGJET ZAKONORE NË FISET E SHQIPËRISË
SË VERIUT (TRIESHI, HOTI DHE GRUDA)

Për Arnb. Mal Berisha
Përzemërsisht
Drita Ivanaj
21/12/2021

ROMË - Vjeshtë 1921

MALUKA

IN NOME DI S.M. VITTORIO EMANUELE III.

PER GRAZIA DI DIO E PER VOLONTÀ DELLA NAZIONE

RE D'ITALIA

Noi Professore Grand'Ufficiale Francesco Scaduto

RETTORE DELLA REGIA UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI ROMA

veduti gli studi percorsi e gli esami sostenuti dal Signor Ivanaj Martino

figlio di Doda nato a Podgoritza (Montenegro)

ha ottenuto proclamato Dottore in Giurisprudenza il - 12 - Dicembre - 1921.

Dato in questa Regia Università degli Studi di Roma addì - 15 - Dicembre - 1921.

IL RETTORE

F. IL PRESIDE DELLA FACOLTÀ

IL DIRETTORE DELLA SEGRETERIA

Tassa di pergamena - 10655 -

MAL BERISHA

VEPRIMTARI TË NDRYSHME TË ORGANIZUARA NGA FONDACIONI "MARTIN & MIRASH IVANAJ", NËN KUJDESIN E ZNJ. DRITA IVANAJ

Dr. MARTIN IVANAJ

First Century Commemoration

Përkujtimi i 100-vjetorit

1921 – 2021



R. UNIVERSITA' di ROMA

Tesi di Laurea

K A N U N I I L E K Ë S

(Codex Alexandri)

LEGGI CONSUETUDINARIE NELLE TRIBU' DELL'ALBANIA SETTENTRIONALE (TRIESHI, HOTI e GRUDA)

Martin IVANAJ

R O M A - Autunno 1921

Teza e Diplomës së Dr. Martin Ivanaj

UNIVERSITETI MBRETËROR I ROMËS

KANUNI I LEKËS

(Codex Alexandri)

LIGJET ZAKONORE NË FISET E SHQIPËRISË

SË VERIUT (TRIESHI, HOTI DHE GRUDA)

Për Amb. Mal Berisha

Përzemërsisht

Drita Ivanaj

21/12/2021

ROMË - Vjeshtë 1921

MALUKA

DAI


THE IVANAJ FOUNDATIONS
OF NEW YORK & TIRANA
Dr. MARTIN IVANAJ
First Century Commemoration
Përkujtimi i 100-vjetorit
1921 – 2021

IN NOME DI S.M. VITTORIO EMANUELE III.

PER GRAZIA DI DIO E PER VOLONTÀ DELLA NAZIONE

RE D'ITALIA

Noi Professore Grand'Ufficiale Francesco Scaduto

RETTORE DELLA REGIA UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI ROMA

veduti gli studi percorsi e gli esami sostenuti dal Signor Ivanaj Martino

figlio di Doda nato a Podgoritza (Montenegro)

Lo abbiamo proclamato Dottore in Giurisprudenza il - 12 - Dicembre - 1921.

Dato in questa Regia Università degli Studi di Roma addì - 13 - Dicembre - 1921.

IL RETTORE

IL PRESIDE DELLA FACOLTÀ

IL DIRETTORE DELLA SEGRETERIA

Reg. pergam. - 10655 -

NALTESIMI I ISKANDERIT (The Rise of Iskander)

Benjamin Disraeli



M&M IVANAJ FOUNDATION INSTITUT

CHARLES TELFORD ERICKSON

AMERIKANI QË I KUSHTOI JETËN SHQIPËRISË

PREZANTIM HISTORIK
NGA

MAL BERISHA
Ish-Ambasador dhe Studiues
www.Malberisha.com



DATA	25 Nëntor, 2019 18:00 - 19:30.	
ADRESA	M&M Ivanaj Foundation Institut, Rr.Perlat Rexhepi, Nd19, H.9, Tiranë	RSVP: info@ivanaj-foundations.org +355 (4) 450 2680

M&M IVANAJ FOUNDATION INSTITUT

CHARLES TELFORD ERICKSON

A GREAT AMERICAN WHO DEDICATED HIS LIFE TO ALBANIA

HISTORICAL PRESENTATION
BY

MAL BERISHA
Former Ambassador and a Scholar
www.Malberisha.com



DATE	November 25, 2019 18:00 - 19:30.	
ADDRESS	M&M Ivanaj Foundation Institut, Rr.Perlat Rexhepi, Nd19, H.9, Tiranë	RSVP: info@ivanaj-foundations.org +355 (4) 450 2680

M&M IVANAJ FOUNDATION INSTITUT

HERMAN BERNSTEIN
MIK I SHQUAR I SHQIPTARËVE

PREZANTIM HISTORIK
NGA

MAL BERISHA
Ish-Ambasador dhe Studiues
www.Malberisha.com



DATA 10 Dhjetor, 2019 18:00 - 19:30.

ADRESA M&M Ivanaj Foundation Institut,
Rr.Perlat Rexhepi, Nd19, H.9, Tiranë

RSVP: info@ivanaj-foundations.org
+355 (4) 450 2680

19:33
Friday, January 17, 2020

FONDACIONI M&M IVANAJ, NEW YORK – TIRANË
PREZANTIM RRETH VEPR
BENJAMIN DISRAELIT
NALTËSIMI I ISKA
(Dy herë Kryeministër i Mbretërisë së Bas
1881
nga MAL BE
17 Janar
www.Malb

NALTESIMI I ISKANDERIT
(The Rise of Iskander)
Benjamin Disraeli
BENJAMIN DISRAELI
NALTËSIMI I ISKANDERIT
PREZANTIM HISTORIK
NGA
MAL BERISHA
NALTESIMI I ISKANDERIT
(The Rise of Iskander)
Benjamin Disraeli
BENJAMIN DISRAELI
NALTËSIMI I ISKANDERIT
PREZANTIM HISTORIK
NGA
MAL BERISHA

FONDACIONI M&M IVANAJ, NEW YORK – TIRANË
PREZANTIM RRETH VEPRËS SË
BENJAMIN DISRAELIT (1876-1935)
NALTËSIMI I ISKANDERIT
(Dy herë Kryeministër i Mbretërisë së Bashkuar; 1868, 1874 – 1880
nga MAL BERISHA
17 Janar 2020
www.Malberisha.com

Falemn
Malberisha

THE FLIGHT OF TIME
THE IVANAJ FOUNDATIONS